



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.248/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Violeta Rugova Husaj - kryesuese, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti - anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën Blerim Krasniqi, kandidat për asamble komunale nga radhët e e subjektit politik Nisma Socialdemokratike e Kosovës të paraqitur kundër komisionerëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), Gllogoc, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 20.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa ZL.Anr.248/2025, e datës 18.10.2025, e parashtruar nga Blerim Krasniqi, kandidat për asamble komunale Blerim Krasniqi, kandidat për asamble komunale nga radhët e subjektit politik Nisma Socialdemokrate e Kosovës paraqitur kundër komisionerëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), Gllogoc për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 18.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit për asamble komunale nga radhët e subjektit politik Nisma Socialdemokratike e Kosovës me të cilën pretendon se ankesa ka të bëjë me disa probleme serioze që kanë ndodhur gjatë zgjedhjeve të fundit, përkatësisht ka pasur mungesë të votave në sistemin zgjedhor, pavarësisht se qytetarët dhe anëtarët e familjes së tij kishin votuar në mënyrë të rregullt. Disa nga qendrat e votimit me të cilat pretendon se ka pasur shkelje dhe duhet të hetohen janë këto qendra të votimit : 0317/01, 317/02, 31703 nuk janë regjistruar votat e familjarëve të mi, të cilët kanë votuar në këto qendra, Halil Bajraktari 302 – votat e familjes time mungojnë në këtë qendër; Ali Gashi 0303 – votat e një familjari mungojnë këtu; Qendra 0304 – po ashtu, votat e familjarëve të mi nuk janë regjistruar; Qendrat 311, 312, 313, 318, 325, 326, 328 – votat e familjarëve të mi mungojnë gjithashtu në këto qendra. Me tutje deklaron se një numër i konsiderueshëm i votave janë shpallur të pavlefshme, edhe pse qytetarët e kanë ushtruar të drejtën e tyre të votës në mënyrë të rregullt. Kjo kishte ndikuar në rrezikimin e rezultateve të drejtë dhe të saktë zgjedhore.

Me këtë kërkon hetim të detajuar dhe verifikim të regjistrimit të votave në sistemin elektronik të KQZ, për të siguruar që të gjitha votat që janë hedhur, të regjistrohen në mënyrë të drejtë dhe të saktë. Kjo është e nevojshme për të garantuar integritetin e zgjedhjeve dhe për të mbrojtur të drejtën e çdo qytetari për të votuar.

Në përgjigjen në ankesë të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve – KQZ, theksojnë se pretendimet e palës ankuese, Blerim Krasniqi nga subjekti politik NISMA Socialdemokrate i cili pretendon se ka pasur mungesë të votave pavarësisht se qytetarët dhe anëtarët e familjes së tij kanë votuar në mënyrë të rregullt në qendra të votimit të lartcekura në ankesë, pra në këto qendra të votimit i mungojnë votat e familjarëve. Gjithashtu pala pretendon se një numër i konsiderueshëm i votave i janë shpallur të pavlefshme edhe pse qytetarët e kanë ushtruar të drejtën e tyre të votës në mënyrë të rregullt, dhe kjo ka ndikuar në rrezikimin e rezultateve. Në ato vendvotime janë numëruar vetëm votat për Subjektet Politike, pra jo për kandidat. Formularët të cilët janë bashkangjitur janë formular indigo nga vendvotimet për subjektet politike, rrjedhimisht këto nuk kanë të bëjnë me votat e kandidatëve, sepse numërimi për vota të kandidatëve ka ndodhur në QKN dhe nga të cilët janë krijuar formularët digjital, janë printuar dhe nënshkruar nga ekipi i numërimit.

Bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunal të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar me 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura lidhur me procesin e numërimit në QKN.

Tutje KQZ ka theksuar se rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimeshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LZP, pala mund të ushtrojë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP.

Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonin apo mbështesin pretendimet e tij të paraqitura në ankesë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar

Paneli i PZAP-së i vlerësoj pretendimet ankimore pretendimet ankimore se kandidati për Asamble Komunale nga subjekti politik i NISMA-s Blerim Krasniqi në Gillogoc se gjatë

procesit të numërimit të votave për kandidatë të kuvendit komunal, pretendon se duhet të numërohen në QV : 0317/01, 317/02, 0317/03 nga se nuk janë regjistruar votat e familjarëve të tij, të cilët kanë votuar në këto qendra por erdhi në përfundim se këto pretendime janë të pa bazuara nga se i njëjti nuk e ka dëshmuar me prova konkrete pretendimet e tij edhe pse i referohet parregullsive gjatë numërimit të votave.

Paneli vlerësoi bazuar në nenin 117.3 të LZP-së përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*". Sipas kësaj dispozite ligjore parashtruesi i ankesës duhet të sjell dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me pretendimet e tij, por që në këtë rast ankesa e parashtruar nga Blerim Krasniqi, kandidat për asamble komunale e subjektit politik Nisma Socialdemokrate e Kosovës, nuk ka bashkangjitur asnjë provë, dhe pretendimi se duhet të ketë rinumërim të votave mbetet vetëm i natyrës deklarative dhe se nuk është mbështetur me asnjë provë që do të dëshmonte pretendimet ankimore.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se "*PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht*" dhe Neni 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: "*PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë*", andaj vlerësoj se ankesa e lartë përmendur nuk është e bazuar dhe të njëjtën vendosi që ta refuzoj si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZLAnr.248/2025 më datën 20.10.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Rugova Husaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

A.A.nr.97/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Delushe Halimi, kryetare e kolegjit, Nenad Lazic dhe Faton Ademi, anëtar të kolegjit, duke vendosur sipas ankesës së kandidatit për Asamble Komunale në Komunën e Gllogocit, Blerim Krasniqi, nga subjekti politik: Nisma Socialdemokrate, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.248/2025, të datës 20.10.2025, në seancën e mbajtur më datë 24.10.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET ankesa e kandidatit për Asamble Komunale në Komunën e Gllogocit, Blerim Krasniqi, nga subjekti politik: Nisma Socialdemokrate, Priset vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.248/2025, të datës 20.10.2025, dhe çështja i kthehet Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) në rivendosje.

A r s y e t i m

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me vendimin ZL.Anr.248/2025, të datës 20.10.2025, ka vendosur: Refuzohet e pa bazuar ankesa ZL.Anr.248/2025, e datës 18.10.2025, e parashtruar nga Blerim Krasniqi, kandidat për asamble komunale Blerim Krasniqi, kandidat për asamble komunale nga radhët e subjektit politik Nisma Socialdemokrate e Kosovës paraqitur kundër komisionerëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), Gllogoc për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.



Kundër vendimit të lartpërmendur, kandidati për Asamble Komunale në Komunën e Gllogocit, Blerim Krasniqi, nga subjekti politik: Nisma Socialdemokrate, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke propozuar që Gjykata Supreme të aprovojë ankesën si të bazuar, të anuloj vendimin e PZAP ZL.Anr.248/2025, të datës 18.10.2025, ndërsa ankesa të miratohet si e bazuar në gjendjen faktike dhe në dispozita ligjore.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur nga kandidati për asamble komunale Blerim Krasniqi, ka kërkuar nga gjykata që ankesa A.A.nr.97/2025, të datës 23.10.2025, parashtruar nga kandidati për asamble komunale nga radhët e subjektit politik Nisma Socialdemokrate, të paraqitur kundër vendimit të PZAP-it, të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i PZAP-it, ZL.Anr.248/2025 të datës 20.10.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datën 18.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit për asamble komunale nga radhët e subjektit politik Nisma Socialdemokratike e Kosovës, me të cilën pretendon se ankesa ka të bëjë me disa probleme serioze që kanë ndodhur gjatë zgjedhjeve të fundit, përkatësisht ka pasur mungesë të votave në sistemin zgjedhor, pavarësisht se qytetarët dhe anëtarët e familjes së tij kishin votuar në mënyrë të rregullt. Disa nga qendrat e votimit me të cilat pretendon se ka pasur shkelje dhe duhet të hetohen janë këto qendra të votimit: 0317/01, 317/02, 31703 nuk janë regjistruar votat e familjarëve të mi, të cilët kanë votuar në këto qendra, Halil Bajraktari 302 - votat e familjes time mungojnë në këtë qendër; Ali Gashi 0303 votat e një familjari mungojnë këtu; Qendra 0304 - po ashtu, votat e familjarëve të mi nuk janë regjistruar; Qendrat 311, 312, 313, 318, 325, 326, 328 - votat e familjarëve të mi mungojnë gjithashtu në këto qendra. Me tutje deklaron se një numër i konsiderueshëm i votave janë shpallur të pavlefshme, edhe pse qytetarët e kanë ushtruar të drejtën e tyre të votës në mënyrë të rregullt. Kjo kishte ndikuar në rrezikimin e rezultateve të drejtë dhe të saktë zgjedhore.

Në përgjigjen në ankesë të ushtruar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), theksohet se: pretendimet e palës ankuese, Blerim Krasniqi nga subjekti politik NISMA Socialdemokrate i cili



pretendon se ka pasur mungesë të votave pavarësisht se qytetarët dhe anëtarët e familjes së tij kanë votuar në mënyrë të rregullt në qendra të votimit të lartcekura në ankesë, pra në këto qendra të votimit i mungojnë votat e familjarëve. Gjithashtu pala pretendon se një numër i konsiderueshëm i votave i janë shpallur të pavlefshme edhe pse qytetarët e kanë ushtruar të drejtën e tyre të votës në mënyrë të rregullt, dhe kjo ka ndikuar në rrezikimin e rezultateve. Në ato vendvotime janë numëruar vetëm votat për Subjektet Politike, pra jo për kandidat. Formularët të cilët janë bashkangjitur janë formular indigo nga vendvotimet për subjektet politike, rrjedhimisht këto nuk kanë të bëjnë me votat e kandidatëve, sepse numërimi për vota të kandidatëve ka ndodhur në QKN dhe nga të cilët janë krijuar formularët digjital, janë printuar dhe nënshkruar nga ekipi i numërimit.

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë të KQZ-së, PZAP-i, ka nxjerr vendimin ZL.Anr.248/2025, të datës 20.10.2025, me të cilën e ka refuzuar ankesën e kandidat për asamble komunale Blerim Krasniqi, duke vendosur si në dispozitiv të vendimit të ankimuar.

PZAP, në arsyetim të vendimit të atakuar ndër të tjera ka theksuar se: Paneli i PZAP-së i vlerësoj pretendimet ankimore se kandidati për Asamble Komunale nga subjekti politik i NISMA-s Blerim Krasniqi në Glllogoc se gjatë procesit të numërimit të votave për kandidatë të kuvendit komunal, pretendon se duhet të numërohen në QV : 0317/01, 317/02, 0317/03 nga se nuk janë regjistruar votat e familjarëve të tij, të cilët kanë votuar në këto qendra por erdhi në përfundim se këto pretendime janë të pa bazuara ngase i njëjti nuk ka dëshmuar me prova konkrete pretendimet e tij edhe pse i referohet parregullsive gjatë numërimit të votave.

Paneli vlerësoi se bazuar në nenin 117.3 të LZP-së përcaktohet se: “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”. Sipas kësaj dispozite ligjore parashtuesi i ankesës duhet të sjell dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me pretendimet e tij, por që në këtë rast ankesa e parashtuar nga Blerim Krasniqi, kandidat për asamble komunale e subjektit politik Nisma Socialdemokrate e Kosovës, nuk ka bashkangjitur asnjë provë, dhe pretendimi se duhet të ketë rinumërim të votave mbetet vetëm i natyrës deklarative dhe se nuk është mbështetur me asnjë provë që do të dëshmonte pretendimet ankimore.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht” dhe Neni 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e



Parashtrimi dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i mund në përgjithësi të refuzoj një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste prima facie ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë”, andaj vlerësoj se ankesa e lartë përmendur nuk është e bazuar dhe të njëjtën vendosi që ta refuzoj si në dispozitiv të këtij vendimi. Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e PZAP, lidhur me refuzimin e ankesës të parashtruar nga kandidat për asamble komunale Blerim Krasniqi.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka rezultuar se vendimi i PZAP-së, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, i aplikueshëm sipas Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale dhe në kundërshtim me Rregulloren nr. 01/2025 të PZAP-së për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosjes së Ankesave, dhe si rezultat i kësaj nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike, duke aplikuar në mënyrë të gabuar edhe të drejtën materiale, duke e refuzuar ankesën e parashtruar nga kandidatja për asamble komunale.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në rastin konkret PZAP, gabimisht ka vendosur me refuzimin e ankesës të parashtruar nga kandidati për asamble komunale, për faktin se:

PZAP-i nuk ka dhënë arsye të qëndrueshme dhe bindëse në raport me pretendimet ankimore, madje arsyet janë kundërtënëse në vetvete, pasi në njërin anë potencon se është refuzuar ankesa për shkak të mungesës së dëshmive ndërsa në anën tjetër potencon se ato që janë dorëzuar nga ankuesja përbëjnë cenim të lirisë dhe fshehtësisë së votës. Arsyetimi në raport me pretendimet ankimore është i pa qëndrueshëm, jo i mjaftueshëm sepse nuk është dhënë përgjigje në raport me secilin pretendim e madje pretendimeve kryesore iu ka jep përgjigje pa hetim fare, pra nuk mund të anashkalohet fakti i dëshmive që janë në dosjen e lëndës sepse në proces zgjedhor dëshmi tjera palët nuk kanë mundësi të sigurojnë për shkak të pamundësisë së qasjes në Qendrën e Numërimit.

Për më tepër, mënyra e hetimit të parregullësive të pretenduara në Qendrën e Numërimit është përmes hapjes së kutive të votimit, dëshmitë e vetme që pala ka mundësi të i siguroj janë deklaratimet e qytetarëve por deklarime të vullnetshme. Qytetarët e nënshkruar në formular,



formularin e kanë deponuar në institucionin përkatës që garanton integritetin e procesit zgjedhor PZAP dhe nuk e kanë bërë publike, andaj me qëllim të hetimit dhe verifikimit të pretendimeve dhe për hirë të ruajtjes së integritetit të procesit zgjedhor këto paraqesin dëshmi për procedim dhe hetim të mëtutjeshëm.

Si rrjedhojë, gjykata vlerëson se PZAP me rastin e shqyrtimit të ankesës së ankuesit nuk ka vepruar në pajtim me nenin 117 [Procedurat e PZAP-së] par.4 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku përcaktohet se: *“PZAP-ja mund të urdhëroj rinumërimin e fletëvotimeve në një vendvotim apo qendër votimi si dhe shqyrtimin e materialit votues si pjesë të hetimeve për ankesën e parashtuar”*, si dhe nenin 15 [Zhvillimi i Hetimeve të Materialit Zgjedhor] par.3, pika 3.1 të Rregullores 01/2025 për Procedurat e Parashtimit dhe Vendosijes së Ankesave, ku përcaktohet se: *“3. Duke u bazuar në ankesat e paraqitura për shkeljet e supozuara në QNR, QKN, PZAP-i, mund t'i kryej këto hetime: 3.1 hetimi i kutisë së votimit.”*

Të metat e mësipërme janë të atij karakteri që e bëjnë të pamundur që Gjykata Supreme të vendos ndryshe, për faktin se me nenin 117 të LZP-së, është në kompetencë të PZAP-it, që gjatë vendosjes për një ankesë të shqyrtojë dhe hetojë të gjitha dëshmitë relevante, andaj në rastin konkret është dashur që të siguroj dhe hetoj materialin zgjedhor, veçanërisht kutitë e votimit, që nënkupton vërtetimin e dëshmive që paraqesin provë të rëndësishme për të vlerësuar ecurinë e procesit zgjedhor në secilën qendër votimi të pretenduar.

Në kontekstin e mësipërm, kjo Gjykatë konsideron se lidhur me procesin zgjedhor, të gjitha këto akte dhe veprime të organeve kompetente zgjedhore, duhet të jenë të plota, të sakta, dhe në përputhje me të gjitha aktet dhe veprimet zyrtare, sikundër edhe në harmoni me Parimet Themelore të përcaktuara me dispozitat e nenit 2 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, gjë që në rastin konkret rezulton se nuk është vepruar drejtë.

Në rivendosije, PZAP, udhëzohet që të shqyrtoj edhe njëherë pretendimet ankimore të ankuesit, provat e deponuara dhe të procedojë tutje në hetimin e këtyre pretendimeve përkatëse që të sigurojë që mos të cenohet integriteti i procesit zgjedhor dhe secila votë të shkojë në destinimin e synuar dhe mos të ketë devijim të vullnetit të qytetarëve.



Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.97/2025, datë 24.10.2025.

Kryetare e kolegjit,

Delushe Halimi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDUJE

Pinëtori i autorizuar
Ovlaščeni radnik
[Signature]



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës AA-976025
Oznaka spisa:

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtësës, fëmijë, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatečen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obaveštenja da radi dostavljanja bude u određenom vremenu u svom radnom mestu, dostava je izvršena: odraslom članu domaćina. Primaoca nastojniku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vrata stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201__ në ora _____ u _____ cas.
Shkaku i refuzimit të marrjes _____
Razlog odbijanja prijmea _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shkruar shkaku pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac neписьмен ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljaoc, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTUENDIJA
24.10.2025

Numri i shtojcave: _____
broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur më (me fjalë)

Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma (i slovima) 27.12.2025

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që e ka marrë aktin në vend të tij)
Potpis primaoca ili lica koje je pismo primilo u zameni V.SH
13.4.1

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaoca